




Qendra Kosovare për Studime Gjinore  
Kosovar Gender Studies Center



# GRATË NË POLITIKË DHE QEVERISJE: PERCEPTIMET E TË RINJVE/TË REJAVE



Një projekt i financuar nga BE dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë



## FALËNDERIM

“Gratë në politikë dhe qeverisje: Perceptimet e të rinjve/të rejave” është hulumtim i Qendrës Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ) i kryer nga AnketaCo. Ky hulumtim publikohet në kuadër të projektit “Gratë e reja të përfshira në parti politike dhe procese politike”, projekt i financuar nga BE dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.

**Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ)** QKSGJ-ja ka kontribuar në përfshirjen gjinore që nga viti 2002 dhe ka bërë përpjekje të vazhdueshme për arritjen e barazisë gjinore në Kosovë. QKSGJ-ja ka qenë nismëtare për të ndryshuar sistemin diskriminues në Kosovë, normat shoqërore dhe standardet e dyfishta dhe ka qenë shumë aktive në monitorimin e institucioneve publike. Misioni i QKSGJ-së është integrimi i perspektivës gjinore në të gjitha analizat, programet dhe politikat e të gjithë sektorëve të shoqërisë kosovare, përmes ngritjes së vetëdijes për çështje gjinore, zhvillimit të studimeve gjinore, krijimit të politikave të ndjeshme nga aspekti gjinor përmes hulumtimeve, avokimit dhe lobimit. Adresa: Rr. Nëna Terezë Nr. 18/1, 10000 Prishtinë – Kosovë, Tel. +381 (0) 38 735 991, [www.kgscenter.net](http://www.kgscenter.net)

**Redaktore: Luljeta Demolli dhe Dafina Prekazi**

**Përkthyes: Lavdi Zymberi**



### **Klauzolë e përgjegjësisë:**

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Qendrës Kosovare për Studime Gjinore dhe AnketaCo dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë.

### **E drejta autoriale**

E drejta autoriale © Prill 2018, Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ) të gjitha të drejtat të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të shpërndahet ose të transmetohet në çfarëdo forme apo me çfarëdolloj mjeti, elektronik, mekanik, fotokopjimi, incizimi ose ndryshe, pa lejen paraprake të publikuesit, me përjashtim të rasteve të citimeve të shkurtra të shprehura në shqyrtime kritike dhe disa përdorimeve të tjera jokomerciale të lejuara me Ligjin për të Drejtat Autoriale.



## PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	2
FIGURAT .....	3
SHKURTESAT .....	4
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	5
2. PSE KANË RËNDËSI VOTUESIT E RINJ/VOTUESET E REJA?.....	7
2.1. Sfondi i hulumtimit .....	7
3. METODOLOGJIA.....	9
3.1. Si është zhvilluar hulumtimi? .....	9
3.2. Kush i është përgjigjur pyetjeve?.....	9
4. BOTA E VOTUESVE TË RINJ/VOTUESEVE TË REJA.....	13
4.1. Çfarë i nxit ata/ato?.....	13
4.2. Sjellja e votuesve të rinj/votueseve të reja dhe preferencat për partitë politike.....	17
4.3. Preferencat e votuesve të rinj/votueseve të reja për cilësitë e udhëheqësve politik në nivel lokal.....	24
4.4. Perceptimet e votuesve/votueseve për gratë në politikë dhe pozita drejtuese .....	25
Komente përmbyllëse: Çka pas zgjedhjeve të qershorit dhe tetorit? .....	36
BIBLIOGRAFIA .....	39



## FIGURAT

Figura 1. Rajonet e përfshira nga anketa.....	9
Figura 2. Lloji i vendbanimit.....	10
Figura 3. Karakteristikat e mostrës: Niveli më i lartë i përfunduar i shkollimit.....	10
Figura 4. Karakteristikat e mostrës: Statusi i punësimit.....	11
Figura 5. Karakteristikat e mostrës: Vetëvlerësimi i gjendjes ekonomike.....	11
Figura 6. Karakteristikat e mostrës: Siguria e punës brenda 12 muajve.....	12
Figura 7. Sa jeni të interesuar/a në çështjet kulturore?.....	13
Figura 8. Sa jeni të interesuara në çështjet sportive?.....	14
Figura 9. Sa jeni të interesuar/a për çështjet shoqërore?.....	14
Figura 10. Sa jeni të interesuar/a për çështjet ekonomike?.....	15
Figura 11. Sa jeni të interesuar/a për çështjet fetare?.....	16
Figura 12. Sa jeni të interesuar/a për çështjet politike?.....	17
Figura 13. Media kryesore e përdorur për t'u informuar.....	18
Figura 14. Sjellja e votuesve për përzgjedhjen/preferencat partiake.....	19
Figura 15. Faktorët e rëndësishëm për të përcaktuar votën në nivel të përgjithshëm.....	19
Figura 16. Faktorë të tjerë të rëndësishëm në përcaktimin e votës në zgjedhje të përgjithshme.....	20
Figura 17. Anëtarësimi në parti politike.....	21
Figura 18. Votimi në zgjedhjet e fundit.....	22
Figura 19. Pritjet sa i përket drejtësisë së zgjedhjeve të ardhshme lokale.....	22



Figura 20. Qëllimi për të votuar në zgjedhjet e ardhshme lokale.....	23
Figura 21. A keni vendosur për cilën parti do të votoni? .....	24
Figura 22. Cilësitë që duhet të kenë politikanët/politikanet .....	25
Figura 23. Cilësitë që duhet të kenë politikanët/politikanet .....	25
Figura 24. A janë të afta gratë kosovare për politikë/qeverisje? .....	26
Figura 25. Rëndësia e ekzistimit të kuotës për përfaqësim gjinor në Kosovë.....	27
Figura 26. A i duhen politikës më shumë gra? .....	27
Figura 27. Gratë kundrejt burrave në qeverisje .....	28
Figura 28. Gjasat e grave dhe burrave për t'u korruptuar.....	29
Figura 29. Sa është mjaftueshëm gra në politikë.....	29
Figura 30. Pajtimi me kuotën zgjedhore .....	30
Figura 31. Efektiviteti i mënyrave të qytetarisë aktive në Kosovë.....	31
Figura 32. Efektiviteti i mënyrave të qytetarisë aktive në Kosovë.....	32
Figura 33. A jeni qytetar/e aktiv/e? .....	33
Figura 34. Perceptimet për performancën e institucioneve publike.....	33
Figura 35. Cilësitë që të rinjt/të rejat duhet të kenë për të zhvilluar karrierë politike .....	34
Figura 36. Tri problemet më të mëdha në Kosovë.....	35



## SHKURTESAT

ABGJ Agjencia për Barazi Gjinore

AAK Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

AKR Aleanca Kosova e Re

KQZ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

QKSGJ Qendra Kosovare për Studime Gjinore

LDK Lidhja Demokratike e Kosovës

LBGJ Ligji për Barazi Gjinore

MAPL Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

PDK Partia Demokratike e Kosovës

VV VETËVENDOSJE



# 1.

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

**K**y raport i hulumtimit është kryer si pjesë e projektit “**Gratë e reja të përfshira në parti politike dhe procese politike**”, që synon të shtojë pjesëmarrjen e grave të reja si votuese dhe udhëheqëse në Kosovë dhe të rrisë vetëdijen për rëndësinë e pjesëmarrjes së plotë të grave në skenën publike dhe politike. Gratë kanë të drejtë të marrin pjesë në proceset politike dhe pjesëmarrje të barabartë në pozitat vendimmarrëse në institucionet shtetërore, shoqërinë civile dhe partitë politike. Megjithatë, në praktikë, këto të drejta nuk zbatohen në mënyrë efektive.

Viti 2017 ishte vit zgjedhor për Kosovën, si në nivelin komunal edhe atë qendror. Të dyja këto procese u konsideruan të drejta dhe demokratike përkundër faktit që ato pothuajse përjashtuan plotësisht gratë, të cilat përfaqësojnë 50% të popullsisë. Në rastin më të mirë, proceset zgjedhore mund të konsiderohen si gjysmë-demokratike, duke pasqyruar kështu zbatimin e standardeve demokratike dhe praktikave për gjysmën e përfshirë të popullsisë. Koalicionet e mëdha në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës patën ndikim të pafavorshëm për gratë në partitë politike dhe në veçanti për ato në garën zgjedhore. Grave kandidate iu dha shumë pak hapësirë gjatë fushatës dhe vetëm një numri të vogël të grave brenda secilit koalicion iu dha hapësirë në ngjarjet kryesore zgjedhore. Edhe mbulimi mediatik i grave kandidate nuk ishte i kënaqshëm, marrë për bazë që në shumicën e debateve zgjedhore në





stacionet lokale televizive morën pjesë burrat. Rrjedhimisht, tepër pak gra kaluan pragun për një ulëse në kuvend me vota të tyre dhe pa kuotën gjinore Kuvendi i Kosovës do t'i ngjante shumë përbërjes së qeverisë që doli nga zgjedhjet.

Sa i përket grave kandidate për kuvende komunale, edhe ato pranuan hapësirë shumë të kufizuar gjatë fushatës zgjedhore. Shumica e mediave dhe vëmendjes publike ishte në garën për kryetarë/e komunash, duke çuar në një monopol të plotë të burrave në këto fusha. Madje edhe emisionet dhe debatet në media që përfshinë analistë në studio, rrallë kishin panele të barabarta nga aspekti gjinor. Si pasojë, zgjedhjet lokale i ngjanin klubeve private të burrave, duke diskriminuar kështu plotësisht 50% të popullsisë. Edhe përkrahja politike nga niveli qendror rrallë erdhi nga gratë, dhe zakonisht kufizohej në udhëheqësin e partisë dhe disa burrave të tjerë.

Një pasqyrim i tillë tragjik i pabarazisë gjinore në politikë i përforcon më tutje paragjykimet ekzistuese kundër grave në politikë sa i përket vënies në dyshim që ato janë të duhura apo të afta për të garuar. Këto perceptime paragjykuese konfirmohen edhe nga të rinjt/të rejtat që morën pjesë në anketim, hollësitë e të cilit janë dhënë më poshtë. Sistemi patriarkal dhe vlerat arkaike të bazuara në Kanunin e Lekë Dukagjinit, Kod Moral dhe Shoqëror i Shekullit të XV-të, janë kthyer në diskursin publik përmes kryeministrit të tanishëm dhe disa udhëheqësve tjerë të lartë politik. Kryeministri aktual përforcoi sistemin patriarkal dhe stereotipat gjinor duke i dalë në mbrojtje disa ministrave dhe personave tjerë që u raportuan nga mediat se kanë shtënë me armë në një festim. Ai e bazoi përkrahjen e tij për veprimet e zëvendësit të tij në Kanun. Një tjetër rast i tillë



ishte kur ish-kryeministri (tani Presidenti) dhe Kryetari i Kuvendit kishin shkuar të ndërmjetësojnë në një “pajtim” sipas Kanunit mes dy deputetëve të Kuvendit të Kosovës që ishin përfshirë në një incident të armatosur me njëri-tjetrin. Mendësia e klanit ku familja e gjërë luan një rol në vendimmarrjen individuale dhe kjo familje ku burrat i kanë të gjitha funksionet vendimmarrëse ka qenë një nga aspektet më kufizuese për fuqizimin e mirëfilltë të grave në Kosovë. Vendosja e ligjit zakonor mbi ligjet e shkruara të Kosovës dobëson rëndësinë e këtyre të fundit. Duke marrë parasysh që i gjithë përparimi në barazi gjinore është pjesë e ligjeve zyrtare të Kosovës, edhe vlera e tyre dobësohet nga promovimi i ligjit zakonor.

Politika dhe qeverisja nuk janë mjedis mikpritës për gratë. Perceptimet e votuesve të rinj/votueseve të reja, që pritet të jenë pikëpamje më liberale dhe përparimtare në shoqëri, gjithashtu konfirmojnë mospërkrahjen për përfshirjen e grave në politikë dhe qeverisje. Mund të vërehet shpesh edhe objektivizimi i grave dhe stereotipizimi gjinor në media dhe në Kuvend. Stigmatizimi publik, gjykimimi dhe paragjykimi moral gjithashtu janë pjesë e personalitetit publik të grave politikane në Kosovë. Duke qenë më pak në numër se burrat, duke pasur më pak pushtet se ata, gratë i nënshtrohen një analizeje më të madhe morale dhe gjykuese se kolegët e tyre burra. Standardet e dyfishta në diskursin publik vetëm se paraqesin standardet e dyfishta morale që kosovarët janë mësuar t’iu besojnë. Rrjedhimisht, edhe disa nga gratë në mostër e vlerësojnë veten (gratë) si të papërshtatshme dhe të paaftë për qeverisje dhe politikë.

Perceptimet e nxëna nga ky hulumtim gjithashtu dëshmojnë për stereotipizimin dhe stigmatizimin e grave në bazë gjinore, duke i



kontribuar më tej shkurajimit të grave të reja për t'u përfshirë në politikë dhe qeverisje. Megjithëse ato shihen si më të sinqerta dhe me më pak gjasa të korruptohen, nuk favorizohet pjesëmarrje më e madhe e grave nga një pjesë e madhe e votuesve të rinj/votueseve të reja në këtë mostër. Demokratizimi i shoqërisë është i nevojshëm për të pasur demokratizim të plotë të politikës dhe qeverisjes. Futja në përdorim e kuotave në parti politike në të gjitha nivelet mund të jetë zgjidhja më e duhur afatmesme për të demokratizuar partitë politike dhe politikën në Kosovën. Shtimi i fluksit të grave (veçanërisht në nivel lokal) pashmangshëm do të rriste gjithashtu cilësinë e pjesëmarrjes së grave. Gjersa kjo mund të mos jetë zgjidhja ideale, mund të përfaqësojë një nga mënyrat më pragmatike të rritjes së menjëhershme të pjesëmarrjes së grave.

Arsimimi afatgjatë për mundësi të barabarta dhe barazi gjinore është i nevojshëm për të tejkaluar stereotipizimin gjinor që është i rrënjosur thellë në kulturë dhe traditë. Barazia gjinore duhet të prezantohet dhe të merret parasysh veçanërisht në të gjitha nivelet e arsimit. Për më tepër, prindërit e rinj duhet të vetëdijesohen për t'i edukuar fëmijët e tyre për barazi gjinore dhe rëndësinë e saj. Përdërisa kjo paraqet një ndryshim madhor në paradigmat kulturore dhe morale që marrin kohë të konsiderueshme për t'u formësuar, masat e përkohshme të diskutuara më lartë mund të ofrojnë një zgjidhje optimale afatmesme.



## 2.

# PSE KANË RËNDËSI VOTUESIT E RINJ/ VOTUESET E REJA?

### 2.1. Sfondi i hulumtimit

Si pasojë e rezultateve dëshpëruese të zgjedhjeve të vitit 2000, ku gratë kandidate për kuvende komunale fituan vetëm një pjesë të vogël të ulëseve, u prezantua kuota e detyrueshme prej 30%<sup>1</sup> për të siguruar pjesëmarrjen e grave. Kjo masë prodhoi shpejtë rezultate pozitive në parlamentarizmin në Kosovë, duke ndikuar gjithashtu përgjithësisht në imazhin e politikës kosovare. Në mandatin aktual në Kuvendin e Kosovës, gratë përfaqësohen me 30 për qind, d.m.th. nga 120 deputetë, 40 janë gra. Një situatë e tillë ofron dëshmi që një politikë e kuotës (që në vetvete është masë e përkohshme për të nxitur pjesëmarrjen) ka dështuar të arrijë qëllimin e saj parësor, që është pjesëmarrja më e madhe e grave. Përderisa, në teori, kjo masë do të duhej t'iu ofronte grave hapësirë të mjaftueshme për të garuar në politikë në nivel shteti dhe lokal, ajo ka dështuar t'ia dalë. Gjithashtu nuk e ka hapur garën për më shumë gra as në nivel lokal dhe as qendror për të garuar për mandate publike. Përkundrazi, është argumentuar që veçanërisht për gratë e reja jashtë kryeqytetit kjo ka krijuar një pengesë për to (tavan qelqi) për angazhimin e tyre, duke kufizuar garimin mes tyre. Gratë, përkundër që përfaqësojnë

<sup>1</sup>Ligji Nr. 03/L-043 për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës. Gjithashtu shih Ligjin Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës



pak më tepër se 50% të popullsisë në Kosovë, sipas politikave aktuale nuk do të mund kurrë të arrijnë barazinë e plotë dhe të përfaqësojnë një përqindje proporcionale të zyrtarëve/eve publik. Si i tillë, legjislacioni ekzistues duhet të ndryshohet dhe duhet të futen gjëra të tjera në ligje që trajtojnë hendekun mes burrave dhe grave në mënyrë më efektive.

Rëndësia e angazhimit më të madh të grave është e dukshme duke marrë parasysh situatën aktuale në Kosovë. Ish-Presidentja e vendit ishte një grua, për herë të parë në gjithë rajonin. Në Kuvend të Kosovës, nga 14 komisione, gjashtë (6) udhëhiqen nga gratë.<sup>2</sup> Njëkohësisht, Qeveria e Kosovës aktualisht ka vetëm dy gra në pozita ministeriale.<sup>3</sup> Përkundër numrit relativisht të lartë të përfaqësimit të grave në Kuvend të Kosovës dhe kuvende komunale, në pozita të deputeteve dhe këshilltareve komunale, nuk mund të thuhet se pjesëmarrja e grave në vendimmarrjen publike dhe politike ka arritur nivelin e duhur.

Përfaqësimi i grave në nivel komunal në Kosovë është mjaft i kufizuar. Në zgjedhjet lokale të vitit 2013, ishte vetëm një grua kryetare e komunës, kurse pas zgjedhjeve lokale të vitit 2017 nuk ka asnjë grua në këtë pozitë.<sup>4</sup> Shumë pak pozita drejtuese në qeveritë komunale iu janë besuar grave.

Veç kësaj, partitë politike dominohen nga udhëheqës burra që zakonisht përfaqësojnë vendimmarrësit në përzgjedhjen e kandidatëve/kandidateve, në një proces që udhëhiqet më shumë nga klientelizmi

<sup>2</sup> Lista e Komisioneve në Kuvend të Kosovës

<sup>3</sup> Zyra e Kryeministrit: Kabineti qeveritar

<sup>4</sup> Koha për Gratë 2018, faqe 6.



dhe nepotizmi se shkollimi dhe profesionalizmi i kandidatëve/kandidateve. Gratë politike kosovare kanë raportuar në hulumtime të ndryshme që kolegët e tyre burra kanë një prirje për t'i shmangur ato nga takimet ku merren vendime të rëndësishme politike. Vendimet e tilla shpesh merren në takime jozyrtare në kafene dhe restorante në orët e vona të natës. Gjithashtu, ekziston një mungesë e konsideruar e grave në bordet drejtuese të institucioneve publike dhe këshillave të menaxhimit. Disa parti politike në Kosovë e kanë të rregulluar përfaqësimin e grave në politikë në statutet e tyre. Mekanizmi më i shpejtë për gratë në parti politike është Forumi i Gruas.

Votimi familjar dhe gratë që nuk votojnë janë dy çështjet kryesore shqetësuese që kjo fushatë dhe ngritja e vetëdijes do të mundohet të arrijë në njëfarë mase. Përderisa votimi familjar vazhdon të jetë një nga problemet themelore të praktikave të votimit në Kosovë, kjo ndikon negativisht te gratë. Përveç grave votuese nga zonat rurale që konsiderohen si grup i synuar për votim familjar, një tjetër grup që përbën vështirësi janë gratë e moshuara, veçanërisht ato që kanë problem me shkrim e lexim. Në këto raste, është vështirë të sigurohet votim i pavarur për to, pasi që ato shpesh shoqërohen dhe ndihmohen nga një anëtar i familjes. Një analizë e mëhershme e zgjedhjeve, e punuar nga Demokracia në Veprim, gjithashtu dëshmon për hendekun gjinor gjatë votimit. Përkundër numrit të madh të grave votuese në Kosovë, përqindja e grave që votuan në zgjedhjet e fundit ishte më e ulët se përqindja e burrave. Konsiderohet që çdo e treta grua shkon në vendvotime.

Modeli i përfaqësuar nga gratë në politikë është i lidhur ngushtë me rolin shoqëror që ato luajnë në përgjithësi. Politika është një fushë



që tradicionalisht “i ka takuar burrave”, si pasojë identifikohet me cilësitë që i jepen burrave. Kjo e bën të vështirë të krijohet një model i një grupaje politike pa përfshirë tipare stereotipa të burrave. Në anën tjetër, aktualisht kur gratë marrin pozita të rëndësishme politike ato shpesh kritikohen se i “imitojnë” cilësitë e politikanëve burra. Duke ngritur kapacitetet udhëheqëse të 30 grave të reja, projekti kërkon të ofrojë një model se si gratë mund të garojnë suksesshëm në të dyja këto nivele. Qasja mes kolegësh për të përsëritur rezultatet e kërkuara në metodologjinë e zbatimit është një tjetër cilësi e trajnimit të udhëheqjes që duhet të përmendet, që pritet të ketë ndikim të dukshëm në praktikë.

Mënyra në të cilën paraqiten gratë politike në mediat kosovare ndikon në përforcimin e stereotipave gjinor dhe në krijimin e modelit “të përkufizuar paraprakisht” të politikanëve burra/gra. Prania e grave në media zakonisht kushtëzohet nga përfshirja e tyre në çfarëdo debati që merret me “çështje madhore”. Dominimi i plotë i politikanëve burra në mediat kosovare përçon mesazhin tek publiku që ata janë më të prirur për t’u marrë me politikë. Gazetarët duhet të vlerësojnë rëndësinë e barazisë gjinore në ushtrimin e të drejtave politike dhe ta përfshijnë atë në mesazhet e tyre të diskursit të përditshëm kështu që gratë politike bëhet lojtare kyçe dhe nuk marginalizohen nga jeta politike dhe nga jeta publike në përgjithësi. Mediat duhet të sfidojnë prezantimin stereotipizues medial të grave kandidate dhe të marginalizuara në trajtimin e çështjeve gjinore.



## 3.

# METODOLOGJIA

### 3.1. Si është zhvilluar hulumtimi?

Hulumtimi i prezantuar përmes këtij raporti është kompletuar duke përdorur metoda sasiore dhe cilësore përfshirë monitorimin e mediave, shqyrtimin e literaturës dytësore dhe anketës me votues të rinj/votuese të reja deri në 35 vjeç/e. Një përzierje e tillë e metodave mundëson një kornizë gjithëpërfshirëse analitike që merr parasysh si njohuritë teorike të debateve bashkëkohore në politikë ashtu edhe ndikimin e ngjarjeve aktuale në barazinë gjinore dhe përfaqësimin e barabartë të grave dhe burrave në politikë dhe institucionet e lidhura drejtpërdrejt me politikën.

Anketa është zhvilluar me gra të reja votuese të moshës mbi 18 vjeçare dhe burra të rinj që përbëjnë më shumë se 50% të popullsisë së përgjithshme në Kosovë. Prandaj të gjeturat e anketës janë të rëndësishme për referim të mëvonshëm gjatë krijimit të politikave.

Kjo anketë u zhvillua me një mostër prej 650 të të anketuarëve në tërë Kosovën të shpërndarë në mënyrë proporcionale me madhësinë e komunave. Mostra u shtresua sipas shpërndarjes gjeografike (bazuar në listat/qendrat e votimit), kombësisë, gjinisë (47% gra dhe 53% burra), moshës dhe kombësisë dhe llojit të vendbanimit (urban/rural) dhe paraqet një mostër të shtresuar besnikërisht me realitetin në terren.





Sa i përket kombësisë, anketa përfshiu pjesëtarë të komunitetit serb, rom, ashkali dhe egjiptas dhe mostra u nda mes 550 të të anketuarëve shqiptarë dhe 100 të të anketuarëve jo-shqiptarë.

### 3.2. Kush i është përgjigjur pyetjeve?

Sa i përket shpërndarjes gjeografike, Figura 1 paraqet një përmbledhje pamore të mostrës.






FIGURA 1. Rajonet e përfshira nga anketa

Sa i përket shpërndarjes komunale, përqindja më e madhe e të anketuarëve përfshin Prishtinën dhe Prizrenin me përkatësisht nga 25% dhe 20% mostra. Mitrovica përfaqësohet nga 18% e të anketuarëve në mostrë, Gjakova me 11%, e pasuar nga Gjlani dhe Peja që vlerësohen me nga 8% secila dhe 7% u përcaktua për Ferizajn. Sa i përket llojit të vendbanimit, pothuajse gjysma ose 48% e të anketuarëve të përfshirë në anketë vinin nga qendrat më të mëdha urbane, përderisa 34% u anketuan në fshatra, dhe një 16% shtesë në qytete të vogla, duke ofruar kështu një llojllojshmëri më të gjërë të pikave të mostrës. Figura 2 paraqet një pasqyrë pamore të llojeve të ndryshme të vendbanimeve.




**FIGURA 2.** Lloji i vendbanimit

Niveli më i lartë i deklaruar i shkollimit është gjithashtu përfaqësues i realitetit në Kosovë. Përqindja më e vogël e nivelit të shkollimit të përfshirë në këtë anketë është e atyre që nuk e kanë përfunduar shkollimin fillor me 2% e pasuar nga të anketuarët me shkollë fillore të përfunduar me 5%. Përqindja e atyre që nuk e përfunduan shkollën e mesme (e braktisën shkollën) është 4% dhe është shumë më e vogël krahasuar me ata/ato që e përfunduan shkollën e mesme (56%). Shkollimi universitar i të anketuarëve arrin 29% i pasuar nga ata/ato me nivel master deri në 4%. Këto karakteristika të shkollimit janë shumë përfaqësuese të strukturës së shkollimit të popullsisë së Kosovës, që konfirmohet edhe nga statistikat zyrtare të ASK-së. Figura 3 ilustron përbërjen e mostrës sa i përket nivelit të shkollimit.



**FIGURA 3.** Karakteristikat e mostrës: Niveli më i lartë i përfunduar i shkollimit

Figura 4 ofron njohuri për statusin e punësimit të të anketuarëve në mostër. Nga 650 të anketuar të përfshirë në anketë, përqindja më e madhe përbëhej nga persona të papunësuar në kërkim të punës (32%) e ndjekur nga afër nga ata/ato të punësuar/a në sektorin privat (28%). Studentët/et paraqesin grupin e tretë më të madh në mostër me 17% të numrit të përgjithshëm, përderisa ata/ato të papunësuar/a dhe që nuk janë duke kërkuar punë paraqesin 9% të të anketuarëve në mostër. Përqindje e njëjtë (5%) janë të punësuar/a në sektorin publik dhe të vetë-punësuar/a (pronarë/e biznesi).



**FIGURA 4.** Karakteristikat e mostrës: Statusi i punësimit




Përveç statusit të punësimit, një tjetër karakteristikë e rëndësishme e të anketuarëve vjen sa i përket perceptimit të tyre të gjendjes ekonomike në lidhje me mjedisin e tyre rrethues të menjëhershëm. Statistikat e prezantuara në Figurën 5 ilustronë në mënyrë pamore perceptimet e të anketuarëve sa i përket gjendjes së tyre ekonomike. Vetëm 2% e të anketuarëve nuk iu përgjigjën kësaj pyetjeje, përdërisa vetëm 1% thanë që të ardhurat e tyre janë të mjaftueshme për të pasur kursime dhe gjithashtu për të jetuar mirë. 5% e të anketuarëve në mostër thanë që të ardhurat e familjes së tyre janë të mjaftueshme për të jetuar mirë, gjersa shumica e madhe prej 65% e të anketuarëve në mostër raportojnë se të ardhurat e familjeve të tyre janë të mjaftueshme për të pasur një jetë normale. Një 23% tjetër shtesë i të anketuarëve e vlerësojnë situatën e tyre ekonomike me “të ardhurat e familjes janë të mjaftueshme vetëm për të mbi-jetuar”, duke treguar cenueshmëri të lartë ekonomike. Një numër i përgjithshëm prej 4% të të anketuarëve në mostër raportojnë që të ardhurat e familjes së tyre nuk mjaftojnë as për ushqim dhe gjërat themelore (ata/ato marrin ndihma nga fqinjët dhe të afërmit).



**FIGURA 5.** Karakteristikat e mostrës: Vetëvlerësimi i gjendjes ekonomike



Një tjetër aspekt i rëndësishëm për të vlerësuar situatën ekonomike të dikujt dhe perceptimet e tyre për të ka të bëjë me sigurinë e punës së të anketuarëve. Siguria e pritur e krijimit të të ardhurave është një faktor i rëndësishëm që përcakton perceptimet e të anketuarëve për situatën/gjendjen e tyre aktuale ekonomike. Figura 6 më poshtë ofron një zbërthim të përgjigjeve të marra për sigurinë e punës. 30% e të anketuarëve në mostër raportuan se janë shumë të brengosur/a se do të mbeten pa punë vitin e ardhshëm. Përqindja e të anketuarëve mesatarisht të brengosur për një mundësi të tillë është 19%. Një numër i përgjithshëm prej 12% thanë që nuk janë aspak të brengosur; 23% ishin pa përgjigje dhe për rreth 16% të të anketuarëve kjo pyetje nuk ishte e aplikueshme.



**FIGURA 6.** Karakteristikat e mostrës: Siguria e punës brenda 12 muajve



## 4.

# BOTA E VOTUESVE TË RINJ/VOTUESEVE TË REJA


### 4.1. Çfarë i nxit ata/ato?

Për të kuptuar pikëpamjen e votuesve të rinj/votueseve të reja dhe rëndësinë/lidhjen me interesin e tyre për tema të caktuara, anketa ka përdorur një shkallë 6-pikëshe, ku 1 = jam shumë i/e interesuar dhe 6 = aspak i/e interesuar. Sipas rrezikut të llojit të tillë të pyetjeve, një përqindje e dukshme e të anketuarëve e identifikojnë veten në atë që ata/ato konsiderojnë mesatare (3 ose 4), me dy vlerat ekstreme që zgjidhen vetëm nga pjesët e mostrës që kanë mendime më të përcaktuara. Në këtë aspekt, çështjet kulturore dhe sportive dalin të jenë me interes të madh për të anketuarët, përveç çështjeve ekonomike, që natyrshëm, llogariten si çështje të interesit të madh për votuesit/et në mostër.

Sa i përket çështjeve kulturore, 17% e të anketuarëve raportojnë të jenë shumë të interesuar/a dhe një 15% tjetër raportojnë të jenë mesatarisht të interesuar, duke përbërë kështu një 32% në anën pozitive të shkallës së përgjigjeve. 46% e të anketuarëve janë klasifikuar të jenë në përgjigje më neutral me 31% që anojnë më shumë nga të qenit të interesuar/a dhe 15% që anojnë drejt të qenit më shumë të painteresuar/a. Mosinteresimi i qartë për temat/çështjet kulturore është raportuar nga 22% e të anketuarëve në mostër, me 11% që janë më shumë të painteresuar/a dhe 10% që raportojnë që



janë të paineresuar/a fare për asnjë çështje kulturore. Sa i përket gjinisë, gratë e reja votuese shprehën interesim më të madh në këto çështje, me vetëm rreth 5% dallim krahasuar me burrat e rinj votues (G: 20.3% kundrejt B: 14.5% që shpreh nivelin e lartë të interesimit për çështjet kulturore).




**FIGURA 7.** Sa jeni të interesuar/a në çështjet kulturore?

Çështjet sportive ishin grupi i dytë i çështjeve për të cilat u kërkua në anketë niveli i interesit të të anketuarëve. Krahasuar me çështjet kulturore, të anketuarët ishin më me mendime të caktuara/polarizuara kur u përgjigjën për interesimin e tyre në sporte. Një numër i përgjithshëm prej 36% e vendosin veten në anën pozitive të interesimit me 26% që shprehin interesim të lartë dhe 19% interesim mesatar në çështjet sportive. Në anën negative, gjithashtu ekziston një përqindje më e lartë e të të anketuarëve krahasuar me interesimin për çështjet kulturore. 29% e të anketuarëve në mostër vendosën veten si të paineresuar/a në sporte. Përqindja e audiencës më neutrale për sporte është më e ulët se ajo e atyre që shfaqën neutralitet për kulturën. Në këtë aspekt, 19% dhe përkatësisht 14% kanë radhitur interesimin e tyre me 3 dhe përkatësisht 4 në shkallën prej 6 nivelesh. Një pasqyrë e plotë e rezultateve paraqitet në Figurën 8. Kur analizohen përgjigjet nga perspektiva gjinore, gratë e reja votuese shprehin më pak interes në



këto çështje, me mbi 11% dallim krahasuar me burrat e rinj votues (G: 14.6% kundrejt B: 35.8%). Edhe këtu mund të krijohet lidhja sa i përket investimeve të bëra në sport si dhe qasjen e njëanshme gjinore kur caktohen prioritetet në investimet në sporte. Prandaj, vendimi më i fundit për të filluar ndërtimin e një stadiumi të tretë kombëtar për futboll përderisa nuk ka objekte për sporte në mjedisë të mbyllura është një tregues i qartë i anshmërisë gjinore në investimet në sporte, që konfirmohet nga rëndësia e raportuar e sporteve për interesimin e tyre.




**FIGURA 8.** Sa jeni të interesuara në çështjet sportive?

Kategoria e tretë e çështjeve për të cilat u vlerësua niveli i interesimit të të anketuarëve janë çështjet shoqërore. Këto çështje përfaqësojnë interesim për 38% të të anketuarëve me 23% të tyre që raportojnë nivel të lartë të interesit, përderisa, përkatësisht, 15% raportojnë nivelin 2 të interesit për këto çështje. 47% e të anketuarëve raportojnë të jenë neutral sa i përket çështjeve shoqërore, përderisa 15% e tyre raportojnë mosinteresim të qartë për çështjet sociale. Brenda popullsisë së painteresuar të të anketuarëve, 6% raportojnë të mos kenë fare interesim, përderisa 9% e tyre janë kryesisht të painteresuar/a për këto tema. Një pasqyrë e plotë e përgjigjeve të marra për çështjet shoqërore paraqitet në Figurën 9. Analiza gjinore





e përgjigjeve tregon që gratë janë më të interesuara për çështje shoqërore se burrat me 24.1% të tyre që thonë të jenë shumë të interesuara krahasuar me burrat në mostër (21.4%) që rendisin interesimin e tyre për çështje shoqërore si të nivelit më të lartë.




**FIGURA 9.** Sa jeni të interesuar/a për çështjet shoqërore?

Duke marrë parasysh nivelin e varfërisë në vend, situata e raportuar ekonomike e të anketuarëve si dhe statusi i punësimit, është e kuptueshme që çështjet ekonomike paraqesin një temë të interesimit të lartë për të anketuarët. Sa i përket këtyre çështjeve, 48% e të anketuarëve në mostër raportojnë të kenë interes, përdërisa 13% raportojnë mosinteresim të qartë. Kjo deri tani është një temë që paraqet interesim të lartë për të anketuarët, me 32% prej tyre që raportojnë interesim shumë të lartë. 27% dhe përkatësisht 20% kanë radhitur interesimin e tyre për çështjet ekonomike me 3, përkatësisht 4. Vetëm 6% e të anketuarëve në mostër raportojnë të mos jenë fare të interesuar për çështjet ekonomike. Një numër shtesë prej 7% të të anketuarëve radhisin interesimin e tyre me 5 në një shkallë nga 1-6. Përgjigjet e marra nga interesimi i raportuar për çështjet ekonomike paraqitet në Figurën 10 më poshtë. Nuk ka dallime në interesimin e raportuar për ekonomi nga ana e të anketuarëve dhe një përbërje e tillë është mjaft e kuptueshme, duke pasur



parasysh magnitudën dhe ndikimin që çështjet ekonomike kanë si në burra ashtu edhe në gra, është pritur të raportohet interesim i madh nga të dy grupet (31.2% për burrat dhe 30.7% mes grash).



**FIGURA 10.** Sa jeni të interesuar/a për çështjet ekonomike?

Feja, vitin e kaluar, është ngritur si një nga temat kryesore që ka pushtuar fushën publike, kryesisht në lidhje me pjesëmarrjen e kosovarëve në luftërat e huaja, fillimisht me motiv fetar. Prezantimi i kësaj teme nga mediat, përfshirë këtu mediat vendore dhe ndërkombëtare, ka nxitur polarizimin e shoqërisë për këtë temë të fesë në të dy anët e debatit. Kur janë pyetur për të vlerësuar nivelin e tyre të interesimit për çështjet fetare, 32% deklaruan interesim për këto çështje, me 19% që theksuan interesim të lartë. Në anën e mosinteresimit, 18% e të gjithë të anketuarëve raportuan mosinteresim të plotë me një numër shtesë prej 13% që vlerësuan nivelin e tyre të interesimit me 5 (niveli i dytë më i ulët i interesimit), duke u llogaritur bashkërisht për 31% të të anketuarëve në mostër. Polarizimi i lartë i shoqërisë për çështjet fetare që tregohet qartë nga përqindja e lartë e të anketuarëve me mendim të pandryshuar, gjithashtu konfirmohet nga përqindja e ulët e përzgjedhjes së niveleve më neutrale të interesimit (d.m.th. 3 dhe 4). Nëse krahasohet me çështjet tjera (d.m.th. sportet dhe kulturën) ka një nivel të ngjashëm të interesimit të raportuar, por çështjet fetare



kanë pasur më shumë trajtim dhe hapësirë në fushën publike. Përderisa aspekti i sigurisë është i rëndësishë së veçantë për t'u përmendur kur analizohet trajtimi i shtuar i çështjeve fetare, por ndikimi më negativ ka ardhur nga mediat. Shumica e trajtimit të temave të fesë nga mediat ka qenë fuqizim konfrontues i dikotomisë “ne dhe ata”, duke përforcuar kështu mendimet më ekstreme për këtë temë. Madje edhe mediat ndërkombëtare kanë etiketuar komuna të tëra<sup>5</sup> si qendra xhihadi, duke stigmatizuar kështu pjesë të rëndësishme në popullsisë së paradikalizuar.


Edhe raportimi i mediave më të balancuara dështoi të kuptojë thelbin e islamit radikal dhe ekstremizmit të dhunshëm, që është më tepër fenomen individual që vije si përgjigje/shfaqje e ankesave të mbledhura për periudha më të gjata kohore. Në vend të kësaj, shumica e raportimit të mediave ka qenë negativ për nga natyra (d.m.th. duke u përqendruar në lajmet lidhur me fenë) dhe në shumë raste kanë vënë paralele mes fesë dhe terrorizmit. Kjo ka çuar në largim/polarizim më të fuqishëm të atyre segmenteve që në të kundërtën do ta konsideronin veten si besimtarë më të lehtë. Interesimet e qytetarëve/qytetareve në çështjet fetare janë paraqitur në Figurën 11.

Kur analizohet interesimi i raportuar për fenë nga perspektiva gjinore mund të theksohet që gratë raportojnë se janë më pak të interesuara intensivisht se burrat nga mostra. Përderisa 17.6% e grave në mostër vlerësojnë interesimin e tyre në fe si “shumë të interesuara” dhe një numër tjetër prej 15.4% vlerësojnë atë si të interesuara (gjithsej 33% për 2 kategoritë), 20.1% dhe 11.8% e burrave raportojnë të jenë “shumë të interesuar” dhe përkatësisht “të interesuar” (gjithsej 31.8%). Prandaj, sa i përket përfundimeve lidhur

<sup>5</sup> Si rasti i Kaçanikut në mediat e Mbretërisë së Bashkuar.



me nivelet e interesimit dhe intensitetin e tyre nëpër linjat gjinore, mund të arsyetohet se burrat që raportojnë interesim për këtë temë priren të jenë më të zëshëm për këtë, përderisa intensiteti i interesimit për këtë temë është më i ulët nga gratë. Këto dallime në rezultate janë mjaft treguese për perceptimet gjinore të fesë në Kosovë, një prizëm që është shpërfillur pothuajse plotësisht.



**FIGURA 11.** Sa jeni të interesuar/a për çështjet fetare?

Shumica e raporteve të shoqërisë së pavarur civile dhe ndërkom-bëtare drejtojnë gishtin nga qeverisja e dobët, korrupsioni dhe moslogaridhënia si pengesa kyçe e zgjidhjes së cilësdo nga çështjet e përmendura më lartë. Politika e fuqisë manifestohet në tërë skenën politike dhe mosndëshkimi për njerëzit e fortë të lidhur me politikë është i dukshëm. Kur analizohen shumica e problemeve më të mëdha me të cilat ballafaqohet Kosova, përfshirë zhvillimin e ngadaltë politik, shumica e problemeve dhe pengesave lidhet me politikën, partitë dhe elitat politike që papërgjegjshëm kanë shpërdorur besimin dhe burimet publike. Sidoqoftë, votuesit e rinj/votueset e reja shfaqin interesim të paktë në politikë. 18% e të anketuarëve raportojnë të jenë shumë të interesuar për çështjet politike me një tjetër 9% që raportojnë interesim më mesatar. Përqindja e përgjithshme e të anketuarëve që raportojnë interesim në politikë



është 27%, që është më e ulët se për cilëndo kategori të çështjeve të diskutuara në këtë pjesë.

Në anën tjetër, 22% e të anketuarëve raportojnë të mos kenë interesim për politikë, me një numër shtesë prej 15% të tyre që e radhisin interesimin e tyre me shkallën e dytë më të ulët. 35% e të anketuarëve që raportojnë neutralitet (3 dhe 4) për çështje politike duhet të konsiderohet gjithashtu si painteresim për politikën dhe çështjet politike, duke iu shtuar kështu përqindjes së popullsisë së paangazhuar dhe të shkëputur. Duke marrë parasysh përgjigjet në këtë pyete, rezultati i zgjedhjeve dhe shkaqet për rezultat mund të arsyetohen me mungesë të interesimit = mungesë të përfaqësimit = efikasitet i paktë në projektimin e prioriteteve dhe interesit. Rrjedhimisht, votuesit e rinj/votueset e reja, që sipas statistikave të popullsisë llogariten rreth 50% të popullsisë, janë segmenti më së paku i mobilizuar, i trajtuar i popullsisë në Kosovë.

Kur analizohen informatat në kontekst shoqëror të grupit të kësaj moshe në Kosovë, mosinteresi për politikë mund të lidhet me fazat zhvillimore nëpër të cilat ata/ato kalojnë në këtë grupmoshë dhe temat të cilat i shqetësojnë ata/ato në jetën e përditshme. Në praktikë, shumica e të anketuarëve janë të merakosur për studimet e tyre, gjetjen e një pune, gjetjen e një partneri/eje, fillimin e familjes dhe blerjen e shtëpisë. Disa nga grupmosha e njëjtë tashmë merren me trysninë nga të qenit prind dhe përkrahjen për familjet e tyre. Të ballafaquar me kaq shumë trysni dhe sfida, votuesit e rinj/votueset e reja në Kosovë me të drejtë i kushtojnë pak interesim politikës dhe çështjeve politike. Megjithatë, kjo mungesë e vëmendjes dhe interesimit si dhe shkëputja nga politika ka pasuar që kjo kategori



të jetë më së paku e përfaqësuar si në politikë edhe në institucionet publike. Figura 12 paraqet një pasqyrë pamore të nivelit të raportuar të interesimit për çështjet politike.

Interesimi në politikë gjithashtu duket të jetë i lidhur me gjininë, por me margjina të dukshme. 16.1% e të gjitha grave në mostër raportuan të jenë “shumë të interesuara” në politikë krahasuar me 18.7% të burrave në mostër që raportuan intensitetin e njëjtë të interesit. Një numër tjetër prej 7.9% të grave dhe 10.2% të burrave raportuan të jenë “të interesuar/a” në politikë. Dallimi në intensitet i interesit për tema politike besohet të lidhet me interesimin e ulët për të marrë pjesë/për t’u përfshirë në parti politike që dëshmohet nga praktikat në parti politike.




FIGURA 12. Sa jeni të interesuar/a për çështjet politike?


## 4.2. Sjellja e votuesve të rinj/votueseve të reja dhe preferencat për partitë politike

Një nga aspektet më të rëndësishme në të kuptuarit e preferencave të votuesve të rinj/votueseve të reja është të kuptosh si ato janë formësuar. Edhe burimi i informimit ofron njohuri për llojin dhe intensitetin e informatave që formësojnë realitetin e votuesve të rinj/



votueseve të reja. Anketa ka ndarë burimet e informimit të përdorura për t'u informuar në disa tema dhe interesime. Për këtë qëllim, interneti ka dalur si burimi parësor i informimit për çështjet aktuale, politikën, ekonominë, sportin, artin dhe kulturën. Një përqindje edhe më e lartë e të anketuarëve në mostër raportojnë që përdorin internetin si burim informimi për t'i përmbushur interesat tjera.

Burimi i dytë më popullor për informim në të gjitha temat është televizioni. 29% e të anketuarëve në mostër raportojnë se e përdorin atë për çështjet aktuale, situatën politike ose ekonomike si dhe për sport, art dhe kulturë. 10% e të anketuarëve në mostër raportojnë se përdorin TV-në si burim të informimit për interesat tjera. Gazetat, që në një kohë kanë qenë medium kryesor popullor i formësimit të mendimit publik janë në rënie. Vetëm 5% e të anketuarëve në mostër raportojnë se përdorin gazetat për t'u informuar për çështjet aktuale, politikën dhe ekonominë, përderisa vetëm 2% e të anketuarëve i raportojnë gazetat si burimin e tyre parësor për t'u informuar për sport, art, kulturë ose interesa tjera. Radio është burimi parësor i informimit për politikë, çështje aktuale dhe ekonomi për 1% të të anketuarëve në mostër, përderisa 4% e konsiderojnë atë si burim parësor i informimit për art, sport dhe kulturë. Një tjetër përqindje befasuese prej 9% të të anketuarëve raportojnë radion si burimin e tyre parësor të informimit për interesat tjera. Mesatarisht, rreth 10% e të anketuarëve refuzuan të japin burimin e tyre parësor të informimit për të tri pyetjet. Qasja në informim dhe përdorimi i burimeve mediatike nuk bazohet në gjini dhe si gratë e reja edhe burrat e ri raportuan burime dhe praktika të ngjashme.



**FIGURA 13.** Media kryesore e përdorur për t'u informuar

Përveç njohurisë për burimet e informimit të përdorura dhe llojit të informatave të cilave iu ekspozohen votuesit e rinj/votueset e reja, është thelbësore të kuptohet edhe kur ata/ato vendosin se për cilën parti do të votojnë. Në këtë aspekt, të anketuarëve në këtë anketë iu kërkua të ofrojnë përgjigje për kohën dhe natyrën e vendimit të tyre për të votuar. Në këtë fushë, duket që preferencat politike dhe vendimet për cilën parti do të votohet bëhen shumë më përpara se zgjedhjet ose fushata zgjedhore.

Pothuajse gjysma e të anketuarëve në mostër (48%) raportuan që kanë marrë vendimin e tyre 6 muaj para zgjedhjeve ose më herët dhe janë të bindur që nuk do t'i ndërrojnë vendimet e tyre. 16% e të anketuarëve raportuan se kanë marrë vendimin e tyre gjatë fushatë zgjedhore se cilën parti do ta votojnë. Kjo përfaqëson votën e lëkundur që mundohet t'i kushtojë vëmendje fushatës zgjedhore dhe të informohet për vendimin e tyre se cila alternative më së miri i përfaqëson ata/ato dhe vlerat dhe interesat e tyre. Një numër shtesë prej 6% e të anketuarëve raportojnë se marrin vendimin e tyre 1-3 ditë para se të votojnë, që me gjasë motivohet nga marrëdhënia emocionale sentimentale me kandidatët dhe lidhjen e përgjithshme





me fushata, përderisa 13% raportojnë se marrin vendim në ditën e zgjedhjeve. Grupi i fundit që raporton se merr vendimin përfundimtar në ditën e zgjedhjeve se për cilën parti do të votojnë janë kryesisht më të shkëputurit nga politika, por akoma e ushtrojnë të drejtën e tyre të votës. Vota e tyre është ose spontane/emocionale dhe manifestohet më shumë si votë kundër se pro një partie apo kandidati/eje të caktuar, ose si votë e menduar mirë dhe e analizuar nga afër (siç është rasti me publikun me vëmendje të shtuar).

Një pasqyrë e tillë e rezultateve tregon që miliona eurot e shpenzuara për secilën fushatë politike deri më tani janë kryesisht humbje dhe tepër joefektive për të arritur tek audiencia e synuar në veçanti e votuesve të rinj/votueseve të reja. Nëse këto rezultate përkthehen në masa për përfshirjen e votuesve të rinj/votueseve të reja dhe aktivistëve/eve në parti politike, duhet të bëhen përpjekje shumë kohë para fushatës zgjedhore, pasi që përpjekja për të arritur tek votuesit e rinj/votueset e reja gjatë fushatës dhe fitimi i simpatisë së tyre mund të jetë shumë e frytshme. Figura 14 prezanton një përmbledhje të përgjigjeve të marra sa i përket kohës së marrjes së vendimit se për cilën parti do të votojnë të anketuarët. Gratë raportojnë të jenë më të përgjegjshme kundrejt fushatës politike, pasi që ato raportojnë se përcaktojnë votën e tyre më vonë se burrat. 44% e grave krahasuar me 51.3% të burrave në mostrën e njëjtë raportojnë se marrin vendimet e tyre më herë se gjashtë muaj para zgjedhjeve. Përqindja e grave që marrin vendimin ditë para ose në ditën e zgjedhjeve është 4.1% dhe përkatësisht 14.6% (18.7% gjithsej). Për burrat këto përqindje janë pak më të ulëta dhe 11% e tyre raportojnë që marrin vendimin në ditën e zgjedhjeve, përderisa 7.4% e tyre pak ditë para zgjedhjeve (gjithsej 18.4%).





FIGURA 14. Sjellja e votuesve për përzgjedhjen/preferencat partiake


Një tjetër aspekt i anketës pyeti për faktorët që ndikojnë në zgjedhjen e partisë politike, manifestimit dhe intensitetit të tyre. Tetë faktorë të mundshëm gjithsej u renditën që të anketuarët të radhisin rëndësinë e tyre në një shkallë tri-pikëshe (e vogël, mesatare, e madhe). Faktori më i rëndësishëm i raportuar nga të anketuarët që është faktori parësor pas zgjedhjes së tyre për partinë në zgjedhjet shtetërore është udhëheqësi/ja i/e partisë për të cilën gjë 57% e të anketuarëve thonë që është shumë e rëndësishme për ta/to. Faktori i dytë më i rëndësishmi për votuesit e rinj/votueset e reja në mostër është raportuar të jetë interesi ekonomik me 43% të të anketuarëve që e radhisin atë si shumë të rëndësishëm. Ideologjia e partisë është faktori i tretë më i rëndësishëm që të anketuarët e raportojnë që ka ndikim kyç në vendimin e tyre për t'i votuar partitë e zgjedhura, me 39% të të anketuarëve që e radhisin atë si shumë të rëndësishme. Besnikëria ndaj partisë me 34%, përgjegjësia shoqërore (32%), origjina rajonale/familjare e deputetëve/eve të caktuar (31%) dhe mosbesimi ndaj partive (29%) janë çështjet tjera të rëndësishme që të anketuarët kanë raportuar që ndikojnë në vendimet e tyre se për cilën parti do të votojnë në zgjedhjet e përgjithshme. Megjithëse akoma raportohet si



fenomen në çdo zgjedhje, faktori më pak i rëndësishëm i raportuar nga të anketuarët në anketë janë preferencat familjare, që janë radhitur si shumë të rëndësishme nga 24% e të anketuarëve, përderisa konsiderohen deri diku të rëndësishme nga 33% e të anketuarëve, dhe me pak rëndësi nga 35% e të anketuarëve. Një përbërje e tillë e përgjigjeve dukshëm tregon ndikimin e kufizuar që familja ka në vendimin e votuesve të rinj/votueseve të reja se për cilën parti do të votojnë. Figurat 15 dhe 16 paraqesin një përmbledhje të përgjigjeve të marra nga të anketuarët (të radhitura sipas rëndësisë).



**FIGURA 15.** Faktorët e rëndësishëm për të përcaktuar votën në nivel të përgjithshëm



**FIGURA 16.** Faktorë të tjerë të rëndësishëm në përcaktimin e votës në zgjedhje të përgjithshme




Kur analizohen aspektet prioritare që përcaktojnë votimin e përgjithshëm, gratë dhe burrat në mostër kanë disa pikëpamje të përbashkëta për rëndësinë e tipareve për politikanët dhe partitë, por ka edhe dallime të dukshme në përgjigje. Për shembull, si burrat edhe gratë në mostër kanë mendimin e njëjtë për rëndësinë e udhëheqësit/es së partisë dhe raportojnë pikëpamje të ngjashme të rëndësisë në këtë aspekt për votimin e përgjithshëm - 54.5% e burrave krahasuar me 58.9% të grave e konsiderojnë këtë aspekt shumë të rëndësishëm. Dallimet më të mëdha në rëndësinë e raportuar janë sa i përket mosbesimit ndaj partive, ku 33.2% e grave e rendisin atë si të rëndësishëm lartë krahasuar me 26.1% të burrave që e raportojnë rëndësinë e njëjtë që përcakton votën e tyre në zgjedhjet e përgjithshme. Në faktorët/aspektet tjera, burrat dhe gratë kanë pikë të ngjashme me rreth 3% - 4% dallime në rëndësinë e raportuar për secilën prej tyre.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm mbi të cilin hedh dritë anketa është niveli i lidhjes së të anketuarëve në mostrën e raportit me partitë politike. Sa i përket anëtarësisimit në parti politike, 45% e të anketuarëve në mostër raportojnë që nuk identifikohen me asnjë parti politike. Grupi i dytë më i madh në mostër kanë thënë që kanë simpati për një parti (25%), përderisa vetëm 12% e të anketuarëve në mostër raportojnë që të jenë zyrtarisht anëtarë të partive politike. 5% e të anketuarëve në mostër nuk pranuan të përgjigjen në këtë pyetje, përderisa 11% e tyre thanë qartë që nuk janë të interesuar në politikë dhe parti politike. Gratë raportojnë anëtarësimin dhe lidhjen me parti politike në përqindje mjaft më të ulët krahasuar me burrat. Vetëm 9.8% e grave raportojnë që janë të anëtarësuara, me një tjetër 1% që e konsiderojnë veten si anëtare. Një numër shtesë prej 24% raportojnë që kanë simpati për një parti. Shumica e grave në mostër raportojnë që nuk



identifikohen me asnjë parti politike (49.1%). Këto përqindje janë dukshëm të ndryshme për burrat e rinj në mostër ku 14.2% e tyre raportojnë që janë të anëtarësuar, 1% e konsiderojnë veten të anëtarësuar dhe 25.2% raportojnë që kanë simpati për vetëm një parti politike. Përqindja e të anketuarëve burra që raportojnë të mos identifikohen me asnjë parti politike është 41.6%. Ky aspekt (lidhja/anëtarësimi në parti) është i rëndësishëm së veçantë për t'u analizuar pasi që ndikon në angazhimin e përgjithshëm të grave në politikë dhe qeverisje.




**FIGURA 17.** Anëtarësimi në parti politike

Duke marrë parasysh që sjellja është tregues edhe i sjelljes së ardhshme të pritur dhe formësimit të qasjes për të arritur te kategoria e votuesve të rinj/votueseve të reja, në anketë janë pyetur të anketuarët nëse ata/ato e kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre për të votuar në zgjedhjet e fundit të përgjithshme (zgjedhjet e parakohshme). Në këtë pyetje, 60% e të anketuarëve konfirmuan që kanë votuar në zgjedhjet e fundit të përgjithshme. 18% e të anketuarëve thanë që nuk e kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre për të votuar në zgjedhjet e fundit, me një numër shtesë prej 14% që refuzuan të japin përgjigje në këtë pyetje. Gjithsej 4% thanë që nuk kanë pasur të drejtë vote në zgjedhjet e fundit të përgjithshme, me përqindjen e njëjtë të të anketuarëve (4%) që thanë se nuk iu kujtohet nëse kanë votuar.



Një pyetje pasuese për ta konfirmuar nëse ata/ato kanë votuar në zgjedhjet e fundit të përgjithshme ishte për cilën parti kanë votuar. 46% e të anketuarëve refuzuan të japin informata për votën e tyre në zgjedhjet e fundit, dhe me një përqindje të barabartë prej 17% raportuan të kenë votuar për VV dhe LDK. Gjithsej 12% e të anketuarëve konfirmojnë se kanë votuar për PDK, gjersa 5% e tyre për AAK. AKR dhe NISMA janë dy partitë që morën përqindjen më të ulët të konfirmuar në zgjedhjet e përgjithshme nga të anketuarët me 2% dhe përkatësisht 1%. Figura 18 më poshtë ofron një ilustrim pamor të rezultateve të raportuara nga votuesit e rinj/votueset e reja për praktikën e tyre të votimit në zgjedhjet e fundit të përgjithshme.



**FIGURA 18.** Votimi në zgjedhjet e fundit

Përveç pyetjes për shprehitë dhe praktikën e tyre për votimet e mëhershme, përmes anketës gjithashtu u fitua njohuri nga të anketuarët për pritjet nga zgjedhjet e ardhshme lokale dhe qëndrimin e tyre ndaj procesit. Aspektet si drejtësia e perceptuar si për sistemin edhe garën zgjedhore, vetëm 12% konsideruan që procesi zgjed-



hor do të jetë plotësisht i padrejtë dhe i pandershëm, siç do të jenë aspektet e njëjta të garës zgjedhore mes kandidatëve dhe partive. Pjesa më e madhe e të anketuarëve në mostër (42%) konsiderojnë që zgjedhjet lokale do të jenë të drejta dhe të ndershme deri në një masë, përderisa 33% e tyre raportojnë besim të plotë në sistem dhe konsiderojnë që ato do të jenë plotësisht të drejta dhe të ndershme. Raportimi i kaluar për manipulimin e zgjedhjeve nga partitë politike, dhe akuzimet e ndërsjella për pandershmeri ka krijuar një imazh që politika është e pamoralshme, e pandershme, dhe të rinjve/të rejave të paineduara iu duket e vështirë të identifikojnë qartë personat e denjë në politikë dhe parti politike. Duhet të theksohet që perceptimi i drejtësisë së procesit dhe garës mund të ndikojë në një masë të madhe rezultatin e zgjedhjeve. Kjo është në veçanti e vërtetë për votuesit/et e pavendosur/a (atyre që raportojnë se do të përzgjedhin zgjedhjen e tyre për parti në ditën e zgjedhjeve), që në mungesë të zgjedhjes së qartë dhe të parapëlqyer, mund të mos kenë domosdoshmërisht motiv të fortë për të marrë pjesë në zgjedhje.



**FIGURA 19.** Pritjet sa i përket drejtësisë së zgjedhjeve të ardhshme lokale

Pas vlerësimit të perceptimeve të tyre për drejtësinë dhe ndershmerinë e procesit zgjedhor dhe garës zgjedhore, të anketuarët gjithashtu of-



ruan mendime për qëllimin e tyre për të votuar në zgjedhjet e ardhshme. Në këtë pyetje, 79% e të anketuarëve theksuan qëllimin e tyre të qartë për të ushtruar të drejtën e tyre të votës në zgjedhjet e ardhshme lokale. Një numër shtesë prej 11% e të anketuarëve raportuan të jenë të pavendosur/a nëse do të votojnë, përderisa 5% e tyre janë të përcaktuar/a të mos votojnë në zgjedhjet e ardhshme. Gratë në mostër raportojnë skepticizëm më të madh krahasuar me burrat, kështu që vetëm 28.5% e të anketuarëve besojnë që zgjedhjet e ardhshme do të jenë plotësisht të drejta dhe të ndershme, krahasuar me 37.1% të burrave në mostër që kanë të njëjtin mendim.


Ngjashëm me praktikën e votimit në zgjedhjet e përgjithshme të diskutuara më lartë, mendimet për kandidatët/et dhe partitë për zgjedhje lokale gjithashtu formësohen një kohë të konsideruar para zgjedhjeve dhe vendimet se për cilën parti do të votohet tashmë janë marrë nga një numër i dukshëm i të anketuarëve në mostër. 56% e të anketuarëve raportojnë që e kanë vendosur për cilën parti do të votojnë në zgjedhjet lokale, me një numër shtesë prej 3% të tyre që thonë se akoma kanë dyshime mes dy partive. 23% e të anketuarëve në mostër thonë që nuk kanë vendosur për cilën parti do të votojnë, përderisa 17% refuzuan t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.

Përbërja e përgjigjeve në këtë pyetje vërteton më tutje joefikasitetin e fushatave politike për të cilat partitë politike shpenzojnë miliona për të tërhequr më shumë vota për to. Kjo është veçanërisht e vërtetë për votuesit e rinj/votueset e reja, të cilët/at raportojnë shumë pak interesim për çështjet e partive politike dhe politikës. Në fazat e tyre të caktuara zhvillimore, ata/ato shfaqin pak lidhje me politikën, dhe kështu shpesh përdorin votën e tyre emocionale kundër kandidatëve/eve të






tyre më së paku të pëlqyer. Partitë politike që duan të angazhojnë këtë segment të zgjedhësve duhet të krijojnë dhe ndjekin plane afatgjata për të siguruar angazhim të vazhdueshëm të këtyre kategorive në vend se të mundohen të ndikojnë tek ata/ato gjatë fushatës. Figurat 20 dhe 21 paraqesin një përmbledhje pamore të përgjigjeve sa i përket qëllimit për të votuar në zgjedhjet e ardhshme dhe, përkatësisht, nëse ai vendim për cilën parti do të votojnë është marrë tashmë.



**FIGURA 20.** Qëllimi për të votuar në zgjedhjet e ardhshme lokale



**FIGURA 21.** A keni vendosur për cilën parti do të votoni?

Qëllimi për të votuar në zgjedhjet e ardhshme dhe vendimi për cilën parti do të votohet ripohon modelet e diskutuara më lartë. 80.1% e grave krahasuar me 78.2% të burrave kanë ndërmend të votojnë në zgjedhje, përderisa 7.3% e grave kanë vendosur të mos votojnë



krahasuar me 3.4% të burrave që nuk do të votojnë në zgjedhjet e ardhshme. Përqindje identike të grave dhe burrave në mostër e kanë vendosur për kë do të votojnë.

### **4.3. Preferencat e votuesve të rinj/votueseve të reja për cilësitë e udhëheqësve politik në nivel lokal**

Për të identifikuar qartë preferencat e votuesve të rinj/votueseve të reja për cilësitë e nevojshme që duhet të kenë politikanët/et, në pyetësor është bërë dallimi mes shkollimit, talentit për politikë, përvojës profesionale, përvojës jetësore, moralit dhe komunikimit të rrjedhshëm. Të anketuarët ishin të lire të radhisin tipare shtesë që atyre iu duken në veçanti të rëndësishme për t'u përmendur por ata/ato e kanë bërë këtë në vetëm pak raste dhe përgjigjet që i kanë ofruar janë të afërta/ngjasojnë me cilësitë që iu është kërkuar t'i vlerësojnë.

Cilësia më e rëndësishme që një politikan/e duhet të ketë është që ka përfunduar shkollimin e lartë që është konsideruar të jetë “shumë e nevojshme” nga 81% e të anketuarëve në mostër, dhe “e nevojshme” nga një 7% shtesë i tyre. Morali është cilësia/tipari i dytë më i vlerësuar që të anketuarët besojnë është i nevojshëm për të qenë politikan/e. 77% e të anketuarëve besojnë që kjo është “shumë e nevojshme”, me një përqindje shtesë prej 11% të tyre që thonë të jetë “e nevojshme”. Talenti për politikë është cilësia e tretë e vlerësuar nga të anketuarët që e kanë identifikuar si shumë të nevojshme, me 72% të tyre që e kanë zgjedhur këtë përgjigje para mundësive tjera. Një 13% shtesë i të anketuarëve e vlerësojnë këtë aspekt si “të nevojshëm”.

Komunikimi i rrjedhshëm është një cilësi që konsiderohet nga 66% si shumë “e nevojshme”, përderisa 13% e konsiderojnë këtë tipar si “të



nevojshëm”. Dy cilësitë e fundit të radhitura nga të anketuarët si të rëndësishme përfshijnë përvojën jetësore dhe profesionale. Përvoja profesionale konsiderohet si “shumë e rëndësishme” nga 64% e të anketuarëve në mostër, përderisa 15% e tyre e konsiderojnë atë “të nevojshme” për të qenë politikan/e. Cilësia që perceptohet si më së paku e nevojshme nga të anketuarët është përvoja jetësore. Përderisa aftësitë dhe përvoja jetësore janë asetet më të vlefshme të cilat mund t’i sjellin në çfarëdo pune profesionistët, ato nuk vlerësohen nga të anketuarët në mostër. Duke marrë për bazë moshën e tyre dhe faktin që pjesa më e madhe e tyre nuk kanë pasur një rast të vërtetë për të krijuar ndonjë përvojë jetësore, prioriteti i ulët që iu jepet atyre mund të tregojë edhe mungesë vlerësimi për atë lloj përvojë. Vetëm 47% e të anketuarëve vlerësojnë të pasurit e përvojës jetësore si “shumë të nevojshme”, përderisa 15% e tyre e vlerësojnë atë “të nevojshme”. Sa i përket këtij tipari/cilësie të caktuar, është e rëndësishme të vlerësohet që shënon përqindjen më të lartë të të anketuarëve (nga të gjitha cilësitë në listë) me “aspak e nevojshme” dhe “pak e nevojshme”, secila e zgjedhur nga 7% të të anketuarëve. Figurat 22 dhe 23 ofrojnë një pasqyrim pamor të perceptimeve për rëndësinë e cilësive që duhet të kenë politikanët / politikanet.




FIGURA 22. Cilësitë që duhet të kenë politikanët/politikanet




FIGURA 23. Cilësitë që duhet të kenë politikanët/politikanet

#### 4.4. Perceptimet e votuesve/votueseve për gratë në politikë dhe pozita drejtuese


Çështjet dhe pengesat kulturore janë përforcuar nga diskriminimi sistematik i grave në parti politike dhe institucione publike, veçanërisht sa i përket përfaqësimin në pozita të larta vendimmarrëse, dhe përbëjnë dy anët e medaljes. Mentaliteti i prapambetur i politikanëve/politikaneve që i kthehen lehtë Kanunit për udhëzime dhe norma, i lidhur me diskriminimin e bazuar në interesa me qëllim të dominimit të shpërndarjes së burimeve siç është demonstruar në përbërjen e qeverisë së re, janë shkaqet themelore dhe manifestimi i problemit të njëjtë - diskriminimi ndaj grave në politikë, institucione dhe shoqëri në përgjithësi.

Shumica dërrmuese e të anketuarëve në mostër (85%) konsiderojnë që gratë kosovare janë të afta për të qeverisur dhe për t'u angazhuar në politikë. 6% e të anketuarëve janë të mendimit që gratë në Kosovë nuk janë të afta për politikë dhe qeverisje, përderisa 7% dhe përkatësisht 2% nuk kanë mendim, ose thonë që nuk e dinë. Duhet



të theksohet që këto përqindje janë mbizotëruese tek segmentet më të reja të popullsisë votuese, duke treguar një situatë shumë më konservative me segmentet më të vjetra.

Aspekti më i habitshëm i rezultateve i marrë nga këto pyetje vjen në aspektin e balancit gjinor. Kjo e konfirmon një nga pritjet në të cilat ky studim dhe projekti bazohet, që një pjesë e madhe e çështjeve të lidhura me përfshirjen më të madhe të grave në politikë dhe qeverisje është i rrënjosur në vetëperceptimin e grave. 90% e grave në mostër besojnë që gratë kosovare janë të afta për politikë dhe qeverisje, përderisa 3% e tyre nuk i konsiderojnë gratë të jenë të afta për qeverisje/politikë. Përderisa kjo është një pamje shumë më pozitive se ajo e ofruar nga burrat në mostër (9.4% të paafta dhe 77.8% të afta), që pritej të ishin paragjykes në këtë pyetje, gjithashtu shfaq që edhe sot një pjesë e grave të reja në Kosovë janë edukuar/mësuar të besojnë që gratë janë më pak të afta se burrat në sektorët e qeverisjes dhe politikës.




**FIGURA 24.** A janë të afta gratë kosovare për politikë/qeverisje?

Përveç që u pajtuan që gratë në Kosovë janë të afta për qeverisje dhe politikë, shumica dërrmuese e të anketuarëve gjithashtu



pajtohen që është e rëndësishme të ekziston kuota për përfaqësim gjinor. 10% e të anketuarëve në mostër konsiderojnë që kuota për përfaqësim gjinor nuk është e nevojshme, me një përqindje shtesë prej 13% të tyre që thonë se nuk e dinë nëse është e rëndësishme të ketë kuota gjinore. Një përqindje shtesë prej 1% e të anketuarëve kanë refuzuar të përgjigjen në këtë pyetje. Përgjigjet e marra tregojnë përkrahje të fuqishme për politikën e kuotës, megjithëse rezultatet e anketës gjithashtu tregojnë që ka pak njohuri nga të anketuarët për kuotën e përfaqësimit gjinor në Kosovë. Kur janë pyetur të tregojnë përqindjen e ulëseve në Kuvend të Kosovës të rezervuar për deputetet, bazuar në kuotën gjinore, vetëm 21% e të anketuarëve në mostër janë përgjigjur saktë. Pikëpamjet e të anketuarëve për rëndësinë e kuotës për përfaqësim gjinor janë të paraqitura në Figurën 25 më poshtë.

Analiza gjinore e rezultateve për kuotën për përfaqësim politik të grave gjithashtu ofron të dhëna më kuptimplota. 81.5% e grave dhe 69.9% e burrave në mostër konsiderojnë që kuota gjinore është e rëndësishme për realitetin në Kosovë. Në anën tjetër, 7% e grave dhe 12.5% e burrave në mostër nuk mendojnë që kuota gjinore është e rëndësishme për Kosovën. Një përqindje shtesë prej 11% e grave dhe 16% e burrave raportojnë të mos e dinë nëse kuotat për përfaqësim gjinor janë të rëndësishme për t'u zbatuar në Kosovë.




**FIGURA 25.** Rëndësia e ekzistimit të kuotës për përfaqësim gjinor në Kosovë

Një tjetër pyetje të cilës të anketuarët duhej t'i përgjigjeshin është nëse politika kosovare duhet të përfshijë më shumë gra. 66% e të anketuarëve në mostër konsiderojnë që numri i grave në politikën/ qeverisjen e Kosovës duhet të rritet, përderisa 14% e tyre mendojnë që nuk duhet të ketë më shumë gra se që ka aktualisht në politikë/qeverisje. Një përqindje shtesë prej 18% të të anketuarëve në mostër thonë që nuk e dinë ose nuk kanë mendim për këtë çështje. Duke marrë parasysh përqindjen e ulët të përfaqësimit të grave në politikë dhe qeverisje (qeverisja aktuale ka shënuar përfaqësimin më të ulët të grave në pozita vendimmarrëse), fakti që 32% e të anketuarëve nuk e kuptojnë nevojën për përfshirje të më shumë grave në këtë sektor/fushë duhet të lidhet gjithashtu me mungesën e kulturës demokratike dhe trashëgimisë dhe dështimit për ta kuptuar që mungesa e përfaqësimit të grave është një deficit demokratik ose gjysmë-demokrati.



E parë nga perspektiva gjinore, 55.1% e burrave krahasuar me 75.1% të grave konsiderojnë që duhet të ketë më shumë gra në politikë në Kosovë. Përqindja e burrave dhe grave që konsiderojnë se nuk duhet të ketë më shumë gra në politikë në Kosovë është 21.3% dhe përkatësisht 7.3%. 21.6% e burrave dhe 15.3% e grave raportojnë të mos kenë mendim/qëndrim për këtë çështje.



**FIGURA 26.** A i duhen politikës më shumë gra?


Një tjetër aspekt për të cilin iu kërkua të anketuarëve të japin pikëpamjen e tyre është a janë politikanë/e më të mirë burrat apo gratë. Për këtë pyetje 57% e të anketuarëve mendojnë që aftësia për politikë ose qeverisje nuk varet nga gjinia dhe asnjëra nga to nuk është e favorizuar në qeverisje. Megjithatë, duhet të theksohet se një përqindje e dukshme e të anketuarëve (25%) konsiderojnë që burrat janë më të mirë në politikë/qeverisje, përderisa 15% konsiderojnë që gratë janë më të mira në këtë aspekt. Gjithsej 2% e të anketuarëve në mostër konsiderojnë që burrat kanë përparësi ndaj grave për shkak të numrit të madh të mundësive që iu jepen atyre





për t'u angazhuar në politikë për dallim për gratë. Figura 27 ilustron vizualisht mendimet e të anketuarëve dhe aftësinë e burrave dhe grave për të qeverisur.

Sa i përket gjinisë, vetëm 9% e burrave në mostër konsiderojnë që gratë janë më të mira në politikë/qeverisje, përderisa 34% e tyre konsiderojnë që burrat janë shumë më të mirë sa i përket politikës dhe qeverisjes. Një tjetër 2.3% i burrave në mostër anojnë nga epërsia e burrave në qeverisje me arsyetimin se gratë kanë më pak gjasa të angazhohen në politikë. Pjesa më e madhe e burrave të rinj në mostër (52%) konsiderojnë që politika dhe qeverisja nuk janë të lidhura për gjini. Në anën tjetër, 19.5% e grave në mostër konsiderojnë që gratë janë më të mira në qeverisje, përderisa 14.4% e tyre konsiderojnë që burrat janë më të mirë në të. Një 2% shtesë jep gjasën më të ulët që gratë të angazhohen në politikë si arsye për epërsi të burrave, përderisa 62% e tyre konsiderojnë që politika/qeverisja të mos jenë të lidhura për gjini.



**FIGURA 27.** Gratë kundrejt burrave në qeverisje

Korrupsioni është një nga problemet dhe sfidat më të mëdha që Kosova duhet të tejkalojë, i cili është identifikuar nga shumica e



raporteve dhe vlerësimeve ndërkombëtare. Gjithashtu konsiderohet si një nga prioritetet e rëndësishme për Kosovën për ta trajtuar dhe mbetet një nga kriteret e fundit për liberalizim të vizave me BE-në. Në pyetjen se “kush mendoni që ka më tepër gjasa të korruptohet?”, 42% e të anketuarëve në mostër përzgjedhën burrat si më me gjasë për t’u korruptuar. 5% e të anketuarëve në mostër konsiderojnë që gratë janë më të prirura për t’u korruptuar, përderisa 46% e tyre thanë që gjinia nuk ka rëndësi, duke nënkuptuar që korrupsioni nuk varet nga gjinia. Një 4% tjetër i të anketuarëve thonë që nuk e dinë dhe 5% e tyre refuzuan të përgjigjen.

Shikuar nga perspektiva gjinore, përgjigjet duket të jenë mjaft interesante. Një përqindje më e madhe e burrave në mostër (45.3%) konsiderojnë që burrat ka më shumë gjasë që të korruptohen sesa gratë që e kanë këtë mendim (36.2%). Është mjaft interesante përqindja më e madhe e grave sesa burrave në mostër që konsiderojnë që gratë ka më tepër gjasë që të korruptohen (6.7% e grave, 4% e burrave). Rreth 50% e grave dhe 44% e burrave në mostër konsiderojnë se korrupsioni nuk ka gjini, përderisa 4% e burrave dhe 5.7% e grave raportojnë të mos dinë që ka lidhje mes gjinisë dhe korrupsionit.





FIGURA 28. Gjasat e grave dhe burrave për t’u korruptuar



Kur të anketuarët u pyetën në lidhje me përfaqësimin e grave në pozita vendimmarrëse, 54% theksuan që gjysma e numrit të përgjithshëm duhet të jetë gra; 17% thanë që të paktën disa duhet të jenë gra; 15% thanë që nuk duhet të ketë një numër të caktuar; 8% thanë që nuk e dinë dhe 1% refuzuan të përgjigjen.



**FIGURA 29.** Sa është mjaftueshëm gra në politikë

Sa i përket gjinisë, 5.4% e burrave në mostër dhe 11% e grave në mostër thonë që gratë duhet të mbajnë shumicën e pozitave të tilla. Për më tepër, 48% e burrave dhe 59.4% e grave në mostër thonë që përfaqësimi duhet të jetë rreth gjysma gra. 22.9% e burrave dhe 12.9% e grave në mostër konsiderojnë që “të paktën disa gra” duhet të përfaqësohen në pozita vendimmarrëse. 16.6% e burrave dhe 12.9% e grave konsiderojnë që nuk duhet të ketë kuota gjinore për pozitat vendimmarrëse. Një përqindje shtesë prej 5.4% të burrave dhe 2.9% të grave raportojnë të mos e dinë çfarë duhet të jetë përbërja/proporcioni mes burrave dhe grave në pozita vendimmarrëse.

Sipas të anketuarëve, emrat në vijim dhe përqindjet e grave që i përkasin partive të caktuara politike përfaqësojnë më së miri interesat e grave. 14% thanë që Vjosa Osmani nga LDK përfaqëson interesat



e grave më së miri; 6% thanë që Mimoza Kusari Lila nga Alternativa; 5% thanë që përfaqësimi më i mirë bëhet nga Donika Kada Bujupi nga VV; pastaj vjen Blerta Deliu nga PDK me 3% të përgjigjeve; Time Kadriu (AAK) me 1% të përgjigjeve sikur edhe Albena Rashitaj nga AAK.




FIGURA 30. Pajtimi me kuotën zgjedhore

Kur iu kërkua të anketuarëve të japin mendimin e tyre në lidhje me detyrimin ligjor të partive politike për të kandiduar të paktën 30% gra në zgjedhje, 40% theksuan se pajtohen plotësisht me detyrimin ligjor; 33% thanë që pajtohen; 11% nuk pajtohen; 11% thanë që pajtohen pak dhe 2% refuzuan të përgjigjen.

Në aspektin gjinor përgjigjet ishin interesante për t'u theksuar. 31% dhe 35% e burrave raportojnë që pajtohen plotësisht ose që pajtohen në masë të madhe me këto dispozita. Në anën tjetër, 50%



të grave pajtohen plotësisht dhe një përqindje shtesë prej 30% pajtohen deri në një masë me detyrimet ligjore që partitë të përfshijnë gra në listat zgjedhore. 13.9% dhe përkatësisht 3.7% të burrave në mostër nuk pajtohen deri në një masë dhe nuk pajtohen aspak me këtë detyrim ligjor të partive. Gratë, në anën tjetër, raportojnë nivele më të ulëta të mospajtimit me 1.3% të tyre që nuk pajtohen aspak dhe me 7.9% që nuk pajtohen deri në një masë.




FIGURA 31. Efektiviteti i mënyrave të qytetarisë aktive në Kosovë

Në pyetjen “cilat nga mënyrat e qytetarisë aktive mendoni se janë më efektive në Kosovë”, sa i përket ndihmës në mbledhjen e fondeve për bamirësi, 58% thanë që kjo është një mënyrë shumë efektive; 14% thanë që kjo mënyrë është efektive; 15% mendojnë që kjo mënyrë është mesatarisht efektive; 6% thanë që është pak efektive dhe e njëjta përqindje (6%) aplikohet për ata/ato që mendojnë që kjo mënyrë nuk është fare efektive; vetëm 1% refuzuan t’i përgjigjen kësaj pyetjeje. Për më tepër, në aspektin e pjesëmarrjes në ngjarje



të sponsorizuara, 20% thanë që kjo mënyrë është shumë efektive; 24% thanë që kjo mënyrë është efektive; 27% mendojnë që kjo mënyrë është mesatarisht efektive; 14% thanë që kjo mënyrë është pak efektive dhe 13% mendojnë që kjo mënyrë nuk është fare efektive; vetëm 2% refuzuan të përgjigjen në këtë pyetje. Përveç kësaj, në aspekt të peticioneve, 18% thanë që kjo mënyrë është shumë efektive; 22% thanë që kjo mënyrë është efektive; 31% mendojnë që kjo mënyrë është mesatarisht efektive; 17% thanë që kjo mënyrë është pak efektive dhe 11% mendojnë që kjo mënyrë nuk është fare efektive; vetëm 1% refuzuan t'i përgjigjen kësaj pyetjeje. Në aspektin e fundit, sa i përket protestave dhe marsheve, 17% thanë që kjo mënyrë është shumë efektive; 23% thanë që kjo mënyrë është efektive; 29% mendojnë që kjo mënyrë është mesatarisht efektive; 17% thonë që kjo mënyrë është pak efektive dhe 13% mendojnë që kjo mënyrë nuk është fare efektive; vetëm 1% refuzuan t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.





FIGURA 32. Efektiviteti i mënyrave të qytetarisë aktive në Kosovë



Në pyetjen “cilat janë mënyrat e qytetarisë aktive që ju mendoni se janë më efektive në Kosovë”, sa i përket shpërndarjes së informatave/mendimeve në rrjete sociale, 33% thanë që kjo mënyrë është shumë efektive; 27% thanë që kjo mënyrë është efektive, 21% mendojnë që kjo mënyrë është mesatarisht efektive; 12% thanë që është pak efektive; 6% thanë që kjo mënyrë nuk është fare efektive; vetëm 1% refuzuan të përgjigjen në pyetje. Për më tepër, në aspekt të fushatës në emër të ndonjë organizate/grupi, 9% thanë që kjo mënyrë është shumë efektive; 19% thanë që kjo mënyrë është efektive; 30% mendojnë që kjo mënyrë është mesatarisht efektive; 21% thanë që kjo mënyrë është pak efektive dhe 20% mendojnë që kjo mënyrë nuk është fare efektive; vetëm 2% refuzuan t’i përgjigjen kësaj pyetjeje. Përveç kësaj, në aspekt të ndihmës me ndonjë organizatë/grup fetar, 9% thanë që kjo mënyrë është shumë efektive; 14% thanë që kjo mënyrë është efektive; 25% mendojnë që kjo mënyrë është mesatarisht efektive; 21% thanë që kjo mënyrë është pak efektive dhe 29% mendojnë që kjo mënyrë nuk është fare efektive; vetëm 1% refuzuan të përgjigjen në këtë pyetje. Në aspektin e fundit, sa i përket ndihmës për ndonjë parti politike, 7% thanë që kjo mënyrë është shumë efektive; 14% thanë që kjo mënyrë është efektive; 20% mendojnë që kjo mënyrë është mesatarisht efektive; 21% thanë që kjo mënyrë është pak efektive dhe 37% mendojnë që kjo mënyrë nuk është fare efektive; vetëm 1% refuzuan të përgjigjen në këtë pyetje.




**FIGURA 33.** A jeni qytetar/e aktiv/e?

Në pyetjen “a mendoni që jeni qytetar/e aktiv/e”, 45% e të anketuarëve thonë që janë; 34% ishin të mendimit që nuk janë qytetarë/e aktiv/e; 11% thanë që deri më tani nuk e kanë pasur rastin; 3% janë të mendimit që qytetaria aktive nuk funksionon; e njëjta përqindje (3%) aplikohet për ata/ato që thanë që nuk e dinë ose që refuzuan të përgjigjen në pyetje.

Një perspektivë gjinore e rezultateve ofron informata të thella për dallimin në perceptim mes grave të reja dhe burrave të rinj sa i përket qytetarisë aktive. 50.4% e burrave krahasuar me 38.7% të grave në mostër e konsiderojnë veten qytetarë aktiv. 29.7% e burrave dhe 41% e grave e konsiderojnë veten të mos jenë qytetarë aktiv.





**FIGURA 34.** Perceptimet për performancën e institucioneve publike

Në pyetjen “si e vlerësoni punën e këtyre institucioneve”, sa i përket Policisë së Kosovës, 38% u përgjigjën shumë e mirë; 28% u përgjigjën me “e mirë”, 19% mendojnë që nuk është as e keqe as e mirë; 6% thanë e keqe, shumë e keqe ishte përgjigja nga 8% dhe 1% refuzuan të përgjigjen. Për më tepër, sa i përket Forcës së Sigurisë të Kosovës, 37% thanë shumë e mirë; 29% u përgjigjën me “e mirë”, 20% mendojnë që nuk është as e keqe as e mirë; 6% thanë e keqe; shumë e keqe ishte përgjigja nga 8% dhe 1% refuzuan të përgjigjen. Përveç kësaj, sa i përket Kuvendit të Kosovës, 4% thanë shumë e mirë; 8% u përgjigjën me “e mirë”, 23% mendojnë që nuk është as e mirë as e keqe; shumë e keqe ishte përgjigja e 33% dhe 1% refuzuan të përgjigjen. Institucioni i fundit ishte Qeveria e Kosovës për të cilën 5% thanë shumë e mirë; 7% u përgjigjën me “e mirë”;



27% mendojnë që nuk është as e mirë as e keqe; shumë e keqe ishte përgjigja e 31% dhe 1% refuzuan të përgjigjen.




FIGURA 35. Cilësitë që të rinjt/të rejat duhet të kenë për të zhvilluar karrierë politike

Në pyetjen “çfarë karakteristikash/arritjesh/aftësish duhet të kenë të rinjt/të rejat për t’u bërë pjesë e politikës”, në lidhje me aspektin e intelektualitetit dhe shkollimit 90% të të anketuarëve thanë që është shumë e nevojshme; 4% thanë që është e nevojshme; 2% mendojnë që është mesatarisht e nevojshme; 1% thonë që është pak e nevojshme dhe 2% refuzuan të përgjigjen. Për më tepër, sa i përket aspektit të njohjes së gjuhës angleze ose gjuhëve tjera, 71% e të anketuarëve thanë që është shumë e nevojshme; 15% thanë që është e nevojshme; 8% mendojnë që është mesatarisht e nevojshme; 2% thanë që është pak e nevojshme; 3% thanë që nuk është fare e nevojshme dhe 1% refuzuan të përgjigjen. Përveç kësaj, sa i përket aspektit të të pasurit të afërm/e dhe shokë/shoqe



të fuqishëm/fuqishme, 20% e të anketuarëve thanë që është shumë e nevojshme; 9% thanë që është e nevojshme; 14% mendojnë që është mesatarisht e nevojshme; 15% thanë që është pak e nevojshme; 41% thanë që nuk është aspak e nevojshme dhe 1% refuzuan të përgjigjen. Veç kësaj, sa i përket aspektit të bindjes ndaj udhëheqësve/udhëheqëseve, 10% e të anketuarëve mendojnë që është shumë e nevojshme; 8% thanë që është e nevojshme; 16% mendojnë që është mesatarisht e nevojshme; 14% thanë që është pak e nevojshme; 50% thanë që nuk është aspak e nevojshme dhe 2% refuzuan të përgjigjen. Në aspektin e të qenit servil, 8% e të anketuarëve thanë që është shumë e nevojshme; 3% thanë që është e nevojshme; 12% mendojnë që është mesatarisht e nevojshme; 11% thanë që është pak e nevojshme; 65% thanë që nuk është aspak e nevojshme dhe 1% refuzuan të përgjigjen. Në aspektin e fundit të kësaj pyetjeje, nevoja për të qenë të pasur/a, 8% e të anketuarëve thanë që është shumë e nevojshme, 6% thanë që është e nevojshme; 13% mendojnë që është mesatarisht e nevojshme; 11% thanë që është pak e nevojshme; 61% thanë që nuk është aspak e nevojshme dhe 1% refuzuan të përgjigjen.




FIGURA 36. Tri problemet më të mëdha në Kosovë



Në pyetjen e fundit “problemet më të mëdha në Kosovë”, sa i përket aspektit të papunësisë, 37% e të anketuarëve mendojnë që ky është problemi i parë; 21% thanë që ky është problemi i dytë dhe 14% mendojnë që ky është problemi i tretë. Për më tepër, sa i përket aspektit të korrupsionit, 21% mendojnë që ky është problemi i parë; 14% e shohin si problem të dytë dhe 16% mendojnë që ky është problemi i tretë. Veç kësaj, çështja e vizave shihet si problemi i parë nga 16% e të anketuarëve; 8% mendojnë që ky është problemi i dytë dhe 9% thanë që ky është problemi i tretë. Varfëria shihet si problemi i parë nga 7% e të anketuarëve; 15% thanë që ky është problemi i dytë dhe 10% e shohin atë si problem të tretë. Aspekti i fundit (zhvillimi ekonomik) shihet si problemi i parë nga 4% e të anketuarëve; 10% mendojnë që është problemi i dytë dhe 14% mendojnë që është problemi i tretë.



## Komente përmbyllëse: Çka pas zgjedhjeve të qershorit dhe tetorit?

Politika dhe qeverisja nuk janë mjedis mikpritës për gratë. Perceptimet e votuesve të rinj/votueseve të reja, që pritet të jenë pikëpamje më liberale dhe përparimtare në shoqëri, gjithashtu konfirmojnë mospërkrahjen për përfshirjen e grave në politikë dhe qeverisje. Një analizë e fushatave zgjedhor në nivel qendror dhe lokal vërteton hapësirë dhe vëmendjen e kufizuar që iu jepet grave. Rrjedhimisht, shumica e pozitave drejtuese, qoftë në nivel qendror apo lokal, udhëhiqen nga burrat. Përmes vendimeve të tyre prioritetet dhe interesat e burrave marrin mbizotërim absolut, përderisa prioritetet e grave mbeten të patrajtuara. Brenda secilës prej partive të mëdha politike një grup grash kanë arritur kapital dhe njohje politike. Është shumë vështirë për gratë tjera të dalin nga brenda strukturave të partive politike që gjithashtu mbizotërohen nga burra. Interesimi më i madh për çështje kulturore dhe shoqërore i raportuar nga gratë ia kalon atij të raportuar nga burrat në krahasim me sportin dhe politikën ndaj të cilave burrat kanë raportuar interesim më të madh. Udhëheqësit aktual politik në Kosovë janë plotësisht të pandjeshëm sa i përket mospjesëmarrjes së grave. Kjo gjithashtu vlerësohet nga nivelet aktuale të përfaqësimit në nivel qendror dhe lokal që shënon disa nga përqindjet më të ulëta në historinë vetëqeverisëse të Kosovës për pjesëmarrjen e grave. Kthimi në “traditë” dhe përkufizimet arkaike të burrërisë, që disa nga politikanët e lartë iu kanë referuar gjithashtu ka ndikuar negativisht në situatën e përgjithshme të grave në përgjithësi dhe përfshirjes së grave në



politikë në veçanti. Vendosja e ligjit zakonor para ligjeve të shkruara të Kosovës zvogëlon rëndësinë e këtyre të fundit. Duke marrë për bazë të gjitha arritjet në barazi gjinore që janë pjesë e ligjeve zyrtare të Kosovës, edhe vlera e tyre zvogëlohet me promovimin e ligjit zakonor. Për më tepër, pandjeshmëria e tyre për balancit gjinor dhe përfaqësimin e grave evidentohet më tepër me faktin që ky ishte aspekti i parë që u sakrifkua në negociatat për koalicionin qeverisës.

Ngacmimi seksual dhe diskriminimi që ndodh brenda partive politike gjithashtu shkurajon dukshëm angazhimin e grave në politikë. Mund të vërehet shpesh edhe objektivizimi i grave dhe stereotipizimi gjinor në media dhe në Kuvend. Stigmatizimi publik, gjykimi dhe paragjykimi moral gjithashtu janë pjesë e personalitetit publik të grave politikane në Kosovë. Duke qenë më pak në numër se burrat, duke pasur më pak pushtet se ata, gratë i nënshtrohen një analizeje më të madhe morale dhe gjykuese se kolegët e tyre burra. Standardet e dyfishta në diskursin publik vetëm se paraqesin standardet e dyfishta morale që kosovarët janë mësuar t'iu besojnë. Rrjedhimisht, edhe disa nga gratë në mostër e vlerësojnë veten (gratë) si të papërshtatshme dhe të paaftë për qeverisje dhe politikë.

Perceptimet e nxëna nga ky hulumtim gjithashtu dëshmojnë për stereotipizimin dhe stigmatizimin e grave në bazë gjinore, duke i kontribuar më tej shkurajimit të grave të reja për t'u përfshirë në politikë dhe qeverisje. Ato vërtetojnë që edhe votuesit e rinj/votueset e reja në Kosovë raportojnë që janë paragjykses ndaj përfshirjes së grave në politikë dhe qeverisje. Megjithëse ato shihen si më të sinqerta dhe me më pak gjasa të korruptohen, nuk favorizohet pjesëmarrje më e madhe e grave nga një pjesë e madhe e votuesve



të rinj/votueseve të reja në këtë mostër. Një përqindje e rëndësishme e votuesve të rinj/votueseve të reja nuk e konsiderojnë të rëndësishme që të përfshihen më shumë gra në politikë, ata/ato janë pak të informuar/a për kuotën dhe shfaqin anshmërinë e tyre gjinore në të gjitha aspektet.

Në një kulturë politike të një udhëheqësi/eje dhe mentaliteti seksist i prapambetur është i vështirë për gratë që të dalin nga aty. Përderisa udhëheqësi/ja i/e partisë vazhdon të jetë nxitësi kryesor që motivon votën e kosovarëve, standardet (e dyfishta) morale duket të dalin si motivim themelor për votues të rinj/votuese të reja. Përvoja dhe shkollimi janë gjithashtu prioritetet kryesore të kosovarëve, por barazia gjinore duket të jetë e ulët në listën e tyre të prioritetëve, madje edhe për gratë e reja. Ekziston vetëm një parti politike (e krijuar rishtazi) që ka një udhëheqëse. Ish-kryetarja e Gjakovës (e vetmja grua që është zgjedhur në atë pozitë) dhe ish-Ministre e Tregtisë dhe Industrisë është gruaja e vetme që ka mundur të garojë në mënyrë efektive në këtë garë të mbizotëruar nga burrat.

Demokratizimi i shoqërisë është i nevojshëm për të pasur demokratizim të plotë të politikës dhe qeverisjes. Demokratizimi i burimeve të informimit që mund të vëzhgohet në vitet e fundit në Kosovë është hapi i parë drejt një synimi më të madh. Përparimi teknologjik e ka bërë të mundshme që mbi 50% të kosovarëve të marrin informatat e tyre kryesisht përmes burimeve në internet. Megjithatë, burimet e informimit në dispozicion për kosovarët përfaqësojnë kryesisht cilësi të dobët, lajme telegrafike që synojnë klikime për përfitime parash, përderisa pak vëmendje i kushtohet thelbit. Me një përqindje të tillë të lartë të kosovarëve të rinj/kosovareve të reja



që kanë qasje në internet dhe e përdorin atë si burim informimi vije edhe mundësia e madhe për të përdorur burimet në internet për arsimim më të shpejtë dhe ngritjen e vetëdijes së tyre.

Situata në Kosovë pas zgjedhjeve të fundit të përgjithshme dhe lokale mund të konsiderohet si gjysmë-demokraci. Përderisa gjysmës së popullsisë i mohohet pjesëmarrje kuptimplotë në politikë dhe qeverisje, pak gra që marrin pjesë rrallë ngrejnë çështje që i prekin vetëm gratë. Dominimi i “çështjeve madhore politike” siç janë marrëdhëniet me Serbinë dhe shenjimi i kufirit me Malin e Zi, kanë çuar në një klimë të politikës populliste, ku referencat për traditë dhe folklore kanë bërë një kthim të madh. Ky trend prek negativisht gratë e pranishme në politikë, pasi që folklori dhe tradita dukshëm nuk janë në favor të tyre.

Futja në përdorim e kuotave në parti politike në të gjitha nivelet mund të jetë zgjidhja më e duhur afat-mesme për të demokratizuar partitë politike dhe politikën në Kosovën. Përderisa kjo është kërkuar si masë e përkohshme për të nxitur përfshirjen më të madhe të grave në politikë, ndikimi i saj i menjëhershëm do të ishte zgjerimi i pjesëmarrjes së grave në të gjitha nivelet. Shtimi i fluksit të grave (veçanërisht në nivel lokal) pashmangshëm do të rriste gjithashtu cilësinë e pjesëmarrjes së grave. Gjersa kjo mund të mos jetë zgjidhja ideale, mund të përfaqësojë një nga mënyrat më pragmatike të rritjes së menjëhershme të pjesëmarrjes së grave. Kuotat duket të jenë e keqja më e vogël që siguron që demokracia ruhet arsyeshëm dhe se pesëdhjetë për qind e popullsisë nuk është krejtësisht e izoluar nga politika. Ajo ka dëshmuar të jetë instrumenti i vetëm efektiv për të ruajtur nivelet minimale të përfaqësimit (d.m.th. kuvendin shtetëror dhe kuvendet komunale).





Arsimimi afat-gjatë për mundësi të barabarta dhe barazi gjinore është i nevojshëm për të tejkaluar stereotipizimin gjinor që është i rrënjosur thellë në kulturë dhe traditë. Madje me disa nga librat shkollor që aktualisht përdoren në shkollat në Kosovë që vazhdojnë t'i përforcojnë stereotipat gjinor dhe kulturën seksiste, arsimimi i gjeneratave të reja është një sfidë kyçe për t'u tejkaluar. Barazia gjinore duhet të prezantohet dhe të merret parasysh veçanërisht në të gjitha nivelet e arsimit. Për më tepër, nënat e reja duhet të vetëdijesohen për t'i edukuar fëmijët e tyre për barazi gjinore dhe rëndësinë e saj. Përderisa kjo paraqet një ndryshim madhor në paradigmat kulturore dhe morale që marrin kohë të konsiderueshme për t'u formësuar, masat e përkohshme e diskutuara më lartë mund të ofrojnë një zgjidhje optimale afat-mesme.

Përderisa gratë, veçanërisht gratë e reja, janë më së paku fajtores, gjithashtu janë ato që duhet fillimisht të nxiten për të pasur më tepër interesim për politikën, përfshirje më të madhe dhe rol më të madh në qeverisje. Janë ato që duhet ta shtojnë rrugën e tyre përmes shtegut jomikpritës, por ato duhet ta bëjnë këtë për veten e tyre dhe për hir të gjeneratave që do të vijnë. Pa shfaqur ato interesim më të madh, përfshirja dhe rrjedhimisht përgjegjësia në qeverisje, përpjekjet për pjesëmarrje më të madhe të grave mund të jenë të kota.



## BIBLIOGRAFIA

Koha për Gratë 2018. Gjetet në: <http://www.kgscenter.net/site/assets/files/1618/kohapergrate2018.pdf>

Ligji Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës. Gjetet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2549>

Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Gjetet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2722>

Lista e Komisioneve në Kuvendin e Kosovës. Gjetet në: <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,110>

Zyra e Kryeministrit: Kabineti qeveritar. Gjetet në: <http://kryeministri-ks.net/zyra-e-kryeministrit/kabineti-qeveritar/>